

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE**  
**“SIRIUS.WFM” sh.p.k**

Tiranë, më datë 27/09/2022

**NENI 1**

Shoqëria Tregtare “SIRIUS.WFM” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

**NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “SIRIUS.WFM” sh.p.k

**NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Sherbime për menaxhimin e projekteve, shërbim për menaxhimin e riskut, Dizeno, inxhinieri dhe ndërtim, punime, asistencë teknike për impiante dhe makineri të renda, ndërtim dhe mirëmbajtje e impianteve përkohësisht përfshirë shërbime në terren, etj. Kryerja e çdo lloj transporti në Shqipëri përfshirë por pa u kufizuar në transportin me automjete jashtë standartit apo në kushte anormale apo jo standarte. Transporti i lendeve të rrezikshme (të tilla si të djegshme apo substancave eksplozive, etj), si edhe çdo aktivitet tjetër për nevojat e transportit. Shërbim për menaxhimin e proceseve në biznes. Instalime dhe montime paisje GPS. Konfigurime dhe mirëmbajtje sisteme GPS. Sigurimi i pjesëve të këmbimit për të gjitha llojet e pajisjeve të tilla dhe realizimi i shërbimit të mirëmbajtjes, garancisë e të riparimit. Mirëmbajtje dhe shërbime të ndërtimeve, mjeteve motorike, sistemeve informatike, sistemeve energjitike. Konsulencë dhe projektim në fushën e ndërtimeve, infrastrukturave informatike dhe energjike. Tregtim materialeve ndërtimi, sisteme informatike, pjesë këmbimi për automjete, sisteme energjitike. Shoqëria mund të importojë, tregtojë dhe të eksportojë çdo lloj malli, artikulli, pajisje apo të tjera veprimtari brenda kuadrit ligjor, dhe mund të zhvillojë çdo aktivitet të cilësuar të nevojshëm për arritjen e qëllimit kryesor të sjelljes së fitimeve, qëllim për të cilin është krijuar. Dhenie me qira dhe shitje paisjesh monitorimi GPS dhe çdo aksesor të tyre. Shërbim monitorimi gps dhe çdo sensori për matje furnizimi dhe shpërndarjes së rrymës elektrike, furnizimi dhe shpërndarjes me ujë, furnizimi dhe shpërndarjes së naftës. Monitorim të konsumit dhe qarkullimit të karburantit me sistem gps. Shitje dhe blerje mjeteve, kamionash, eskavatoresh, fadromash, veturash dhe servisini i tyre etj. Dhenie me qira dhe qira operacionale e automjeteve të tonazheve të ndryshme. Menaxhimi, ruajtja, arkivimi i informacioneve dixhitale. Sisteme të avancuara sigurie etj..



#### **NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Loni Ligori", pallati ILAD, shkalla 3, hyrja 19, kati 5, Tirane.

#### **NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 Lek. Kapitali ndahet në dy (2) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. Paulo Jose Batista Pataco, shtetas Portugez, i Lindur në Moçambique, më 16.07.1966, me nr. personal 7474049, i cili zotëron 50% të kuotave, e barabartë me një pjesë kapitali, me vlerë të përgjithshme prej 50.000 lek.
2. Ledian Bregu, shtetas Shqiptar, i Lindur në Korçë, më 21.08.1985, me nr. personal 150821028N, i cili zotëron 50% të kuotave, e barabartë me një pjesë kapitali, me vlerë të përgjithshme prej 50.000 lek. .

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

#### **NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### **NENI 7 - ORGANET DREJTUESE**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ledian Bregu, shtetas Shqiptar, i Lindur në Korçë, më 21.08.1985, me nr. personal 150821028N,, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.





**NENI 8**

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

**NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

**NENI 11**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Akt i Themelimit hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKËT**


Paulo Jose Batista Pataco

Ledian Bregu



Paulo Pataco

(emer, mbijemer, firme)



Ledian Bregu

U perkthye ne gjuhen angleze nga Ledian Bregu